



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:160321
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05605755

AA.nr.604/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS– Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit U.D., rr.”...”, nr....-Gj., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, me bazë juridike anulimi i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1624/2021, të datës 17.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, e datës 03.08.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1624/2021, i datës 17.07.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit U.D., rr.”...”, nr....-Gj., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile. Në pikën II. Anulohet vendimi i të paditurës i datës ... dhe vendimi i datës ... dhe paditësit i njihet e drejta në pension të skemës invalid i luftës grupi VII, me shkallë të invaliditetit prej 20 % *deri 30 %*, nga data e parashtrimit të kërkesës 11.12.2017 dhe në vazhdim. Në pikën III. Detyrohet e paditura që paditësit ti kompensoj në mënyrë retroaktive shumën për pensionin të skemës Invalid i Luftës grupi VII, me invaliditet 20 %-30 % , i cili nuk është paguar nga data 11.12.2017 deri më datë 17.07.2023, në shumën mujore të përcaktuar për këtë lloj pensioni, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, kurse nga data 18.07.2023 kompensimi bëhet në baza mujore sipas

shumës së përcaktuar për këtë skemë pensionale. Në pikën IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm. Në pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes përfaqësueses Avokaturës Shtetërore, ka ushtruar ankesë me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovon ankesën e të paditurës, të prish aktgjykimin A.nr.1624/21 të datës 17.07.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës i datës ... si dhe vendimi i datës

Paditësi me datë 14.08.2023, ka ushtruar në gjykatë përgjigje në ankesë me të cilën e ka kundërshtuar të njëjtën me propozim që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe ta vërtetoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin e datës ..., ka refuzuar ankesën e paditësit U.D., me numër të dosjes ... si e pa bazuar për njohjen e të drejtës në pension të familjes së Viktimave Civile. Mbetet në fuqi vendimi nr.... i datës

Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur, ushtron padi në gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit, me propozim që gjykata pas anulimit të aktit kontestues ti njehë të drejtën në pension të skemës invalid i luftës. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 17.07.2023, në prani të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e anulon vendimin e të paditurës, duke vendosur decizivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se bazuar në provat e administruara si dhe ekspertizës mjekësore të datës 03.11.2022 dhe plotësimin me atë të datës 13.04.2023, si dhe deklarimeve të ekspertëve në shqyrtim gjyqësor, ku përcaktohet invaliditeti 24.50 % , përqindje kjo e deklaruar se ka lidhshmëri me luftën si pasojë e plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në luftë, ka konstatuar se këtu paditësi i plotëson kushtet nga neni 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 i Ligjit Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, ku përcaktohen tetë grupet e invalidëve të UÇK, andaj bazuar edhe në konstatimin mjekësor sipas ekspertizës mjekësore edhe është dhënë shkalla e invaliditeti 24.50 % , si pasojë e plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në luftë. Andaj gjykata përballë këtij konstatimi si në ekspertizë-deklarimit në shqyrtim gjyqësor ku përcaktohet invaliditeti prej 24.50 % , e që lidhet me pasojë e plagës, lëndimit apo sëmundjes që ka pësuar në luftë si ekspertizë Gjykata kishte parasysh edhe nenin 3 paragrafi 1 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëmarrësve të UÇK dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës:” 1.7. Invalid i luftës së UÇK-së - pjesëmarrësi i UÇK, organizmi i të cilit është dëmtuar mbi 20% për shkak të plagës, lëndimit apo

sëmundjes që ka pësuar në luftë, apo si i internuar (i burgosur) në burgjet apo kampet e armikut dhe shtetasi i huaj si veteran i UÇK –së, nga 1997- 1999” dhe nenin 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 i po këtij ligji “Grupi VII - invalidët me 20% deri 30% të dëmtimit trupor”, andaj konstatimi si në ekspertizë dhe duke ja falur besimin provave të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, duke vepruar sipas vlerësimit të kërkesës së këtui paditësit gjykata e ka aprovuar padinë dhe kërkesën e saj.

Gjykata konstaton se organi i paditur duke vendosur sipas ankesës së paditësit ka pasur detyrim të nxjerr vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me nenet 47 dhe 48 të LPPA-së, i cili do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjen faktike të çështjes, bazuara në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ, deklarin e bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Arsyetimi të jetë i qartë dhe i argumentuar lidhur me mënyrën e vendosjes ashtu si parashihet në dispozitat e lartcekura të LPPA, kur me akt kufizohen, mohohen, shuhen apo preken interesat ligjore ose, vendosen detyrime apo ndëshkime. Nga këto fakte rezulton se i padituri me mënyrën e vendosjes ka nxjerrë vendim jo të drejtë dhe jo ligjor ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPPA-së.

Gjykata iu ka referua nenit 10 të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i cili parasheh të drejtat e invalidëve të UÇK- së sipas shkallës së invaliditetit, për arsye se paditësi sipas vërtetimit të datës 05.12.2017, paditësi referohet si veteran-invalid i luftës së UÇK dhe po ashtu referuar certifikatës së datës 20.01.2017, evidentohet veteran-invalid i luftës së UÇK, andaj edhe Gjykata kishte për bazë nenin 10 të ligjit të lartcekur.

Gjykata ka vepruar sipas kërkesës së padisë, në kuptim të nenit 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku përcaktohet:” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe ka aprovuar kërkesën nga data e parashtrimit të saj pranë të paditurës datë 11.12.2017.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor konkludimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale me anulimin e vendimit të atakuar me padi, sepse i njëjti nuk është i plotë dhe përmbajtjesor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, sepse është i përfshirë me të meta esenciale. Organi i paditur është dashtë që duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të nxjerr vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me nenet 47 dhe 48 të LPPA-së, i cili do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjen faktike të çështjes, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ deklarin e bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Arsyetimi të jetë i qartë dhe i argumentuar lidhur me mënyrën e vendosjes ashtu si parashihet në nenin 48 të LPPA, kur me akt, kufizohen mohohen, shuhen apo preken interesat ligjore ose, vendosen detyrime apo ndëshkime. Nga këto fakte rezulton se i padituri me mënyrën e vendosjes ka nxjerrë vendim jo të drejtë dhe jo ligjor ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPPA-së. Andaj, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur e aprovon kërkesëpadinë e paditësit dhe anulon vendimin e të paditurës dhe ia njeh të drejtën në pension nga skema invalid i luftës grupi VII, me shkallë të invaliditetit prej 20 % deri 30 %, nga data e parashtrimit të kërkesës 11.12.2017 dhe në vazhdim dhe e detyron të paditurën që t'i kompensoj në mënyrë retroaktive shumën për pensionin të skemës Invalid i Luftës grupi VII, me invaliditet 20 %-30 % ,i cili nuk është paguar nga data 11.12.2017 deri më datë 17.07.2023, në shumën mujore të përcaktuar për këtë lloj pensioni, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, kurse nga data

18.07.2023 kompensimi bëhet në baza mujore sipas shumës së përcaktuar për këtë skemë pensionale.

Kolegji, po ashtu vlerëson se të gjeturat e Gjykatës së shkallës së parë janë të drejta dhe të bazuara sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, kur vendimin e saj e mbështet në ekspertizën mjekësore të datës 03.11.2022, të përpiluar nga eksperti F. M.-ortoped dhe F. A. neurokirurg të cilët kanë deklaruar se te paditësi shkalla e invaliditetit fizik është 14.50 %, kurse me datën 04.11.2022 me mendimin e psikiatrit Dr. S.Sh. ku deklarohet se irritabiliteti, disponimi melankolik pamundësia e funksionimit social, mund të jenë disa nga shenjat apo simptomatologjitë e çrregullimit të stresit posttraumatik, të njëjtat shenja mund të jenë prezentë edhe në disa nga kategoritë dhe gjendjet mjekësore psikiatrike që ndërlidhen me çrregullimin të ankthit, disponimit, personalitetit apo të përshtatjes.

Ndërsa me plotësimin e ekspertizës të datës 13.04.2023 eksperti psikiatër Dr. M. K. ka theksuar se paditësi ka vuajtur dhe vuan ende nga pasojat e lehta të traumave të luftës. Në psikiatri quhen çrregullime të stresit posttraumatik që sipas ICD-10 shënohet Dg/F43.1, forma e lehtë, PTSD është e caktuar 10 % sipas tabelës. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndron prapa ekspertizës së dhënë në aspektin psikiatrik. Konstatohet një përqindje e invaliditetit prej 10% e cila nderlidhet me periudhën e luftes, bazuar në ekspertizën e parë ku invaliditeti percaktohet 14.50% si dhe përqindjes në aspektin psikiatrik prej 10%, në bazë të tabelave të kalkulimit, invaliditeti i përgjithshëm është 24.50%. Sa i përket deklaramit të psikiatrit në shkresat e lëndës, deklaroj se asnje psikiater klinik, por edhe asnje profesionist me çfaredo përvojë qofte klinike, nuk mund ta vleresoj asnje rast njejtë. Andaj bazuar në ekzaminim dhe intervistim direkt të palës, diagnoza është përcaktuar ICD-10, shenohet DG/F43.1. Ky është klasifikim nderkombetar.

Andaj duke u bazuar në atë se paditësi sipas plotësim ekspertizës ka invaliditet 24.50%, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke i njohur paditësit të drejtën në pension të skemës invalid i luftës grupi i VII, sepse duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, neni 5 përcaktohet:” 1.2. Pensioni invalidor personal të cilin e realizojnë: 1.2.1. invalidi i UÇK-së”, kurse me nenin 10 të po këtij ligji përcaktohet: “1. Me qëllim të realizimit të të drejtave dhe beneficioneve, në përputhje me shkallën e invaliditetit dhe përqindjen e përcaktuar të dëmtimit trupor, invalidët e UÇK-së ndahen në tetë (8) grupe: 1.1. Grupi I - invalidët me 81% deri 100% të dëmtimit trupor; 1.2. Grupi II - invalidët me 71% deri 80% të dëmtimit trupor; 1.3. Grupi III - invalidët me 61% deri 70% të dëmtimit trupor; 1.4. Grupi IV - invalidët me 51% deri 60% të dëmtimit trupor; 1.5. Grupi V - invalidët me 41% deri 50% të dëmtimit trupor; 1.6. Grupi VI - invalidët me 31% deri 40% të dëmtimit trupor; 1.7. Grupi VII - invalidët me 20 % deri 30 % të dëmtimit trupor; 1.8. Grupi VIII - invalidët me 10% deri 19% të dëmtimit trupor”.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura nga ana e të paditurës, dhe se arsyetimin e aktgjykimit e bazon thjeshtë në provat dhe të dhënat të cilat i arsyeton paditësi, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë gjatë

shqyrtimit të çështjes nuk i ka konstatuar fare faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, por aktgjykimin e mbështet në provat e paditëses, duke mos marrë parasysh fare faktin se paditësja nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme, duke kuptuar se nuk e ka arsytuar paaftësinë e tij, për çka do të thotë se nuk ka dokumentacion mjekësor që do ta dëshmon të kundërtën. Gjithashtu, kjo gjykatë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 3 paragrafi 1 pika 1.7, nenin 5, par.1 pika 1.2.1, neni 9 par.1 pika 1.1, neni 10 paragrafi 1 pika 1.7, nenin 16 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimin e ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimin.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
AA.nr.604/2023, me datë 03.04.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi